



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 151, Datë 14.10.2019

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ELVA 2001” sha, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “MIVAS” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1940 KW.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1 gërma “a”, nenit 10 pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.10.2019, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ELVA 2001”sha, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, nr. 92/11 datë 08.10.2019 për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ELVA 2001” sha, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, nga HEC “Mivas” me kapacitet të instaluar 1940 kW,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “Elva 2001” sha, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 604 Prot, datë 01.10.2019, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Mivas”, me kapacitet të instaluar 1940 kW.
- Aplikimi i shoqërisë “Elva 2001” sha, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
  - Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar.
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d” “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar pjesërisht.
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar.
  - Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.1; pika 4.1.2; pika 4.1.3; pika 4.1.4 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 4.1.5 gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria “Elva 2001” sha, është një subjekt tregtar i krijuar me vendimin nr. 25441 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, dhe mban numër identifikimi (NUIS) K12809402J.
- Shoqëria “Elva 2001” sha, është mbajtëse e *Miratimit Përfundimtar* për ndërtimin e objektit, hidrocentralit "Mivas", me kapacitet prodhues 1940 kW, në pellgun ujëmbledhës të lumit të Tomorricës, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan me Nr. 2657/2 Prot, datë 27/12/2017, mbështetur në pikën 2 të nenit 49 të Ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 822, datë 07.10.2015 "*Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni*" i ndryshuar
- Shoqëria “Elva 2001” sha, ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastukturës dhe Energjisë (MIE), Kontratën për ndërtimin e objektit, hidrocentralit "Mivas", me kapacitet prodhues 1940 kW, në pellgun ujëmbledhës të lumit të Tomorricës, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan me Nr.5 Rep, Nr.3/3 Kol datë 25.01.2018
- Referuar afateve të vënies në punë të veprës, sipas kontratës sipërcituar, mbajtësi i miratimit merr përsipër të vërë në punë hidrocentralin brënda 21 (njëzetënjë) muajve nga data e marrjes së të gjitha lejeve për fillimin e punimeve, siç është parashikuar në grafikun e punimeve të paraqitur në Aneksin 2, bashkëlidhur kontratës.
- Rezulton se shoqëria ka vijuar me aplikimet për pajisjen me lejet në institucionet përkatëse.
- Shoqëria, në aplikimin e saj, parashikon të vërë në punë Hec-in në datë 01.12.2019.

#### **Për mungesën e dokumentacionit të konstatuar që ka të bëjë me:**

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërma “g”. (dokumenta që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shit-blerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti).
  - Subjekti ka depozituar Kontratën “Për dhënien në përdorim të tokës pa frut” me nr. 1728 prot datë 06.07.2018, lidhur ndermjet Bashkisë- Skrapar dhe shoqërisë “Elva 2001” sha, e cila në nenin 6 të saj ka të parashikuara afatin, i cili rezulton se ka përfunduar më 06.07.2019, me të drejtë ripërsëritje, dhe për këtë shoqëria do të bëjë me dije nëse ka nënshkruar një kontratë të re.
- **Neni 9, pika 4.1.1** (Të dhëna specifike për HEC).  
Në këtë formular subjekti ka lënë pa plotësuar, Pikën 3 të tij; (Vendodhja numri i rregjistrimit të pronës). Pikën 8; (Gjatësia e kanalit të derivacionit), Pikën 11; (Numri i njërive gjeneruese dhe fuqia e instaluar e secilës), Pikën 16; (Rendimenti), Pikën 19; (Jetëgjatësia e pritshme e centralit).
- **Neni 9, pika 4.1.4, germa “e”** – Miratim i Projektit të zbatimit nga organi i caktuar me ligj.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit të sipërcituar, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11 pika 1 të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

- Kontrata për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit "Mivas" me kapacitet prodhues 1.940 kW, në pellgun ujëmbledhës të lumit tomorriçes, Bashkia gramsh, Qarku Elbasan dhe Autoritetit Kontraktues, me Nr.5 Rep dhe Nr.3/3 Kol, lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ka një afat 49 vjeçar, por në zbatim të nenit 38 të Ligjit “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, ERE mund të lëshojë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat deri në 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Elva 2001” sha, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Mivas”, me kapacitet të instaluar 1940 kW.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**